# Procesverbal

(1)

- Mbajtur sot më datë 30.01.2024 ora 10:00 në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak Librazhd
- Pasi u lexua rendi i ditës nga Kryetari i Këshillit të gjithë të pranishmit janë dakort 16 (anëtar)
- Miratohet fillimi i mbledhjes me këtë rend dite si më poshtë vijon:

1. P/vendim "Mbi kriteret e përdorimit të fondit të kushtëzuar për Bllok Ndihmën Ekonomike deri në 6% për vitin 2024".
2. P/vendim "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% periudha dhjetor 2023".
3. P/vendim "Për një shtesë në vkb nr 119 datë 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 të bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2024-2026".
4. P/vendim "Për një ndryshim në vkb nr 119, datë 29.12.202[illegible] Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 të bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2024-2026".
5. P/vendim "Për miratimin e dokumentacionit teknik-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjet që kanë pësuar dëme (dëmtim të plotë së gjallë) nga fatkeqësi natyrore".

→

6. P/Vendim " Për miratimin e listës së ngastrave ku do të kryhet kullotja dhe kositja e barit për vitin 2024".
7. P/Vendim " Prononcim për përfshirje në procedurë privatizimi "
8. P/Vendim " Për miratimin e fillimit të procedurës për dhënie në përdorim të të tretët të pikës së grumbullimit të produkteve bujqësore blegtoriale "Food Hub".
9. P/Vendim " Propozim për dhënien në përdorim të pasurisë shtetërore "
10. P/Vendim " Për vlerësimin me titullin "Qytetar Nderi" Z. Ali Kopaçi".
11. P/Vendim " Për vlerësimin me titullin Qytetar Nderi Z. Haxhi Dede Edmond Brahimaj "
12. Të ndryshme:
   1. P/Vendim " Mbi miratimin në parim të listës emërore të familjeve që përfitojnë nga programi i përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese.
   2. P/Vendim " Për hapje rruge për kalim mjetesh bujqësore ".
   3. P/Vendim " Për miratimin e bashkëfinancimit në masën 20% të programit të kushteve të përmirësimit të banesave.

→

"Te rendi ditës p/vendimin N° 7
dhe N° 9 i tërheqim nga rendi i ditës
Ku Bajram Pishkashi ka theksuar i tërheqim
për të mirëmenduar dhe më mirë.

= Miratohet rendi ditës me tërheqjen e dy p/vendimeve
Miratohet me të gjitha votat pro

Fillimi i mbledhjes.

1. P/vendimi N° 1
R. Shaka " Kriteret e ndihmës ekonomike ne
i fusim çdo fillim viti dhe sjellim para jush
kriteret bazë për të përfituar ndihmën ekonomike

B. Ureta " Ne kërkojmë nga dhe listën pa kush
nuk përfiton dhe të na e vini në dispozicion.
Arsyet pse janë skualifikuar.
Kujtim Albrahimi " A ka familje pa nuk dinë si
të aplikojnë dhe a keni asistuar për ti ndihmuar
R. Shaka " ka shumë familje në nevojë dhe ne
jemi në dijeni të këtyre familjeve.
= Miratohet me të gjitha votat pro

2. P/vendimi N° 2

= Miratohet me të gjitha votat pro.

3. P/vendimi N° 3

→

Bujar Vreto " Ne në muajin e parë (4) kemi miratuar buxhetin për vitin 2024 dhe pse sot ju keni sjellë pranë nesh # në buxhet.

A. Allo " Ne me thesarin akordojmë fondet dhe prandaj sjellim për një shtesë dhe një ndryshim dhe këtu janë fonde të trashëguara.

Fatbardha Oafja " Thjeshtë drejtoresha e Financës ju the që keni relacionin shpjegues dhe nuk duhet marrë majë për mojë sabotim.

Bledi Koçi " Shikoj po në këtë buxhet blerjen e një mjeti zjarrfikës dhe po në buxhetin e trashëguar është parashikuar po blerje automjeti për zjarrfiksen. Pse nuk është bërë blerja e këtij automjeti.

B. Koçi " Ju mendoni që me këtë shumë do të merrni një automjet që i shërben gjithë zonës. Krijoni mundësinë që Bashkia të këtë një automjet të duhur.

Xhelrisim Dodo " Unë shikoj në listën për blerje e një pompe dhe a mundet të blehet më shpejt.

= Miratohet me 15 vota pro dhe 1 abstenim

4. Vendimi Nº 4.

A. Allo " Kjo marrveshje në parim është miratuar thjeshtë është sistemimi i vlerave.

= Miratohet me 15 vota pro dhe 1 abstenim.

5. Vendimi Nº 5

→

"Met Bardhoshi" Në vitin në 2019 ka pas një rënie zjarri për familjen e zotit Bajram Murrashi.

Bujar Ureta" Pse nuk është futur dhe më parë ky p/vendim.

Met Bardhoshi" Nuk kemi pasur fonde të mjaftushme dhe tani është bërë e mundur që të futet në mbledhjen e këshillit.

= Miratohet me të gjitha votat pro.

6. P/vendimi N°6.

A. Brazhda" Si çdo fillim viti ne miratojmë listën e ngastrave ku lejohet kullotja dhe kositja e barit. me kontratë 1-vjeçare.

Bujar Ureta" Ju thjeshtë i administroni këto prona dhe prona nuk ka vajtur te i zoti.

Bledi Koçi" Këto janë dhe për kullotat dhe s ka konflikte midis palëve.

= Miratohet me të gjitha votat pro.

7. P/vendimi N°7.

B. Koçi" Çfarë produktesh janë futur në atë magazinë dhe për çfarë ju shërben gjithë ajo magazinë.

Pëllumb Pishkashi" Se i përket rendit të ditës dhe projekti ka qenë për 3-vite dhe tani në 31 janarë mbaron kontrata. Tani jemi në fazën →

(6)

që magazina FoodHub të jetë për përdorim një palë të tretë. Nuk është përcaktuar akoma dhe e merrni vesh dhe ju sepse do futet për ofertë.

B. Koçi "Kur është marrë në dorëzim magazina?

B. Pishkashi "Tre vite ka qenë projekti.

Bujar Vrető "Po shikoj në diskutime që s'po merremi vesh dhe mendoj të shtyjmë për mbledhjen tjetër. Është një pasuri e jona dhe unë mendoj që nqs do jepet me qera jemë dakort, por nuk jam dakort që ta marri një pronar dhe ta bëj pronën e vetë.

Mikel Bicaku "Nga sek. Përgjithshëm morëm sqarim mëse të duhur dhe nuk shikoj ndonjë problem.

Bledi Koçi "Çfarë roli ke ti si KB.? Çfarë votojmë ne me mbas këtij vendimi. Ne miratojmë një vendim që nuk ka asnjë lloj dokumenti sqarues, të kete një planë biznesi. Të na japi një kopje të kontratës që Bashkia ka lidhur me World Vizionin.

Zalbardha Osja "Kur një Këshilltare kërkon sqarim dhe unë mendoj që të marri sqarimin e duhur dhe ne të vazhdojmë me miratimin e pikës.

Elidjona Bahiti "Kjo qendër a është funksionale?

B. Pishkashi "Në momentin jo.

= Miratohet me 13 vota pro dhe 3 kundra

8. Vendimi N°10

Bujar Vrető "Në emrin tim dhe të PJ jam dakort që të miratohen këto dy dhënie titujt nderi dhe për 2. Ali Kopaçin dhe Salmond Brahimaj jam prap dakort. sepse ai ka qënë dhe oficer në D. Brazhdë.

→

Dhe mendoj që ti votojmë.

Nadriçim Doda " Jam shumë dakort për ti dhënë titullin "Qytetar Nderi" 2. Ali Kopaçin.

Kujtim Abrahimi " Kjo është një kënaqësi për ne si këshilltarë që ti nderojmë me këtë titull.

Z. Ali Kopaçi " Për atë kohë që si ka kontribuar për qytetin e Librazhdit është një vlerë për ne dhe besoj nuk ka asnjë kundërshtim nga ana jonë.

Mitat Bicaku " Të bëhet një ndryshim që titulli i jepet pas vdekjes.

= Miratohet me të gjitha votat pro.

Dhe vendimi N°11 " Miratohet me të gjitha votat pro

Të ndryshme:

1. Vendimi N°1

" Mbi miratimin e listës në parim të listës emërore të familjeve që përfitojnë nga programi i lashtëre të përmirësimit të banesave.

1. Sulzim Kryeziu
2. Asperi Allushi
3. Ramazan Kojku → Gizavesh
4. Halit Rruplli → Lib. Katund
5. Ismail Qoshja → Njësi Lunik

} të jenë në listën për të përfituar nga ky program.

Z. Behiti " Shikoj një familje që është në listë që ka shpinë komplet dhe jo vetëm çatinë.

B. Pishkashi " Kërkojmë ndihmë nga ana juaj për ti shtuar. →

= Miratohet me 15 vota pro dhe 1 kundër Veli Terziu.

Vendimi Nº 2

" Për hapje rruge për kalim mjetesh bujqësore

B. Vreto " Jam pro hapje të kësaj rrugë.

Veli Terziu " A ka konflikt me banoret përreth.

Bajram Pishkash " Për rastin e Nazmiut me dyshime

që ka konflikte dhe mbas verifikimeve rruga kalon

në tokë shtet.

Veli Terziu " A ka konfirmin nga kryeplaku i zonës?

Mitat Bicaku " Ne nuk duam të krijojmë konflikte.

Z. Bahiti " Si rasti i Nazmiut ka shumë raste.

B. Koçi " Do një plan rilevimi që çfarë prone

është

= Miratohet me të gjitha votat pro.

Vendimi Nº 3

= Miratohet me të gjitha votat pro.

- Një pikë te komisionet, na kërkohet nga Shoqata

e Këshillave, që të shtojmë Komisionin e Integrimit.

- Komisioni Juridik, Mbrojtjes, Rendit Publik, Integrimit dhe marrëdhënieve me jashtë.

= Miratohet me të gjitha votat pro me 7 në komision.

1. Silvana Hoxha kryetare
2. Bujar Vreto N/kryetar
3. Erjola Albrahimi anëtare
4. Kastriot Gurra anëtar
5. Arjona Cekrezi anëtare
6. Bardhe Qatja anëtare
7. [illegible] Terziu anëtar

→

Të ndryshme.

Kujtim Abrahimi "Të shikohet tyneli te voloreku

Ilir Kuka "Për shkollën e Funarsit të shikohet emri me përparësi